

KËRKIME GJUHËSORE

Esmeralda HIDRI

Valbona KALO

PËRSËRITJA SI ESENCE DHE FORMULË GJUHËSORE NË HIPERROMANIN “OH” TË ODIN MONDVALSENIT

Nisur nga studimet e fundit kritike që kanë vënë në fokus përsëritjen si gjurmë stilistike e gjuhës së autorit dhe si një komponent i tekstit letrar e aftë të shënjojë unitete qendrore semantike, të cilat kanë gjithnjë domethënie shumëfishe, jemi ndihmuar nga dy vepra shumë të rëndësishme të letrave shqipe, për të nënvizuar specifikisht një veçori të rëndësishme të sajën dhe që e bën atë të aftë të pasqyrojë paraqitjen e një ndërgjegjeje të caktuar kohore e historike.

Përzgjedhja e Odin Mondvalsenit dhe Oh-ut, erdhë jo vetëm nga prania e dukshme e trajtave përsëritëse, por edhe sepse përmes këtyre dy veprave të para si një si një vepër e vetme, një hiper/roman, teknikat dekonstruktioniste të ç'montimit të tekstit do të na ndihmojmë ta shohim gjuhën dhe zgjedhjet e saj si ndihmuese të jashtëzakonshme të interpretimeve letrare, përsëritjen¹.

Duke i lexuar të dy veprat si një të vetme e duke tentuar të interpretojmë dy imazhet përsëritëse Ai dhe Odin Mondvalseni përmes zgjedhjeve gjuhësore, natyrës së fjalive, regjistrit ligjërimit, përzgjedhja kohore dhe tipeve të përsëritjeve në tekstet përkatëse, do të përpiqemi të interpretojmë praninë e një kërcënimi të ngjashëm në të dy veprat, me specifikat dhe dëshmitë e sistemeve prej të cilave gjeneruan.

Do të vëmë në dukje se si kalimi nga niveli makrostruktural përsëritës në atë të mikrostruktural, ku përsëritja shihet jo më në periudha apo sintagma, por në terma leksikorë të ardhura shpesh në trajtën e anaforave, epiforave, anadiplosit dhe polittotos, në vend të krijojë në tekst një lloj ngadalësimi, ndërton ndjesinë e fragmentarizimi dhe thyerje të vazhdueshme. Kjo sepse përsëritja në vend të krijojë efektin e supozuar të sqarimit, në fakt nuk lejon artikulin e qartë lidhës mes pjesëve që kështu i ngjajnë dukurisë gjuhësore të përcaktuar nga Ginsburg si “arabesco”. Specifika e linjave që përsëriten duke u gërshetuar, rikthimi sërish në fund i fragmenteve hyrëse, emra që përsëriten për të mos u harruar asnjë kujtim që lidhet me to, Kështu ndjesia që përftohet është ajo e një pamundësie të gjuhës ose mjeteve gjuhësore, për të paraqitur një realitet, në dukje shumë të thjeshtë, për të mos thënë banal e të parëndësishëm, por, që përmes këtyre përsëritjeve, rezulton i lodhshëm dhe i pakuptuar, sepse në fakt është kompleks dhe duhet ta kuptojnë vetëm sytë e veshët e duhur. Kjo tregon se mosdëshira për ta bërë titullin të vërtetë, ndaj dhe copëtimi i saj, për ta shfaqur sa më të mjegullt, vjen nga arsyeja se kjo e vërtetë vazhdon të jetë e frikshme, dhe të trembë. Dhe dihet se nuk ka situatë më të frikshme, sesa ajo ku dhuna vjen heshturazi e pa i rënë derës, sepse është bërë e shtëpisë.

¹ Sabine Haupt, “Es kehrt alles wieder”, Zur Poetik Literarischer Wiederholungen in der Deutschen Romantik und Restaurationszeit..., Würzburg, 2002, f. 51.

E konsideruar si false dhe e papërshtatshme, gjuha bëhet shërbyese e devotshme e një krijuesi edhe në teknika që mund të quhen të pavlera në fushën e të shprehurit letrar, si të padobishme dhe që të vrasin veshin, siç është përsëritja. Të përsëriturit, duke rrezikuar dhe të bëhesh i bezdisshëm, shfaqet në rastin e kësaj veprë, si një gjetje e përsosur për të ngulitur idenë se historia përsëritet e se fytyrat e tiranëve apo tradhtarëve të dikurshëm, mund të jenë fshirë nga koha, por jo shembulli i tyre dhe mundësia që ato të rishfaqen nën të tjerë emra, por gjithmonë me të njëjtën fytyrë, atë të pandryshueshmen që kanë shfaqur në kohën e tyre.

a. Tipet e përsëritjeve në tekst.

- **Tjetri si vetvetja:** Në veprën e përfutur nga ne, duket qartë se një nga detyrat kryesore të interpretimit do të jetë pikërisht të kuptuarit e paralelizmave që vendosen si kolona të narracionit, sidomos paralelizmi kryesor *Ai/Odin Mondvalsen*, me dy jetët e tyre e dy mbylljet aspak mbyllje. Kemi dy hyrje romani njësoj mbyllëse e izoluese, që përçojnë izolimin fizik, por edhe atë etik të personazhit, e që manifestojnë që në fillim praninë e zërit rrëfimtari, si një *unë* që rrëfen vetveten në një univers të madh sa një nevojtoare apo sa një dhomë hetimi.

Edhe pse kemi pranuar se kemi të bëjmë me universe paralele, ndjesia krahasuese duket sikur vazhdimisht kërkon se cili është *uni* më pranë së vërtetës, apo, e thënë thjesht, se cili është uni i parë. Ndaj theksojmë që në fillim se, edhe pse ndjehet pashmangshmërisht një dilemë e tillë, së cilës nuk i shpëtojmë dot, në të vërtetë bëhet fjalë për dy lloje përsëritjeje e nuk kemi mundësi të gjejmë apo hipotizojmë origjinalin edhe sikur të donim, e nëse vëmë në qendër të idesë sonë faktin se thelbi i të dy këtyre imazheve përsëritëse është tjetri si vetvetja, nuk do të mundim të përcaktojmë se kush është tjetri e kush vetvetja.

Çmontimi i tekstit e sidomos zbërthimi i skemave narrative janë të vetmet procedime që mundësojnë të kuptosh se në ç`mënyrë këto struktura shfrytëzojnë diferencat mes këtyre paralelizmave, duke përcaktuar kështu dhe se çfarë rëndësie u jepet atyre brenda tekstit ².

Nisim fillimisht me rastin e *Unit* të “Oh-ut”, i cili na vetëprezantohet që në fillim përmes një fjalie të tejgjatë, që do të jetë karakteristikë e përhershme e natyrës ligjërimore të personazhit, kur ai i drejtohet dikujt jashtë tekstit, le të supozojmë një lexuesi, fjali të cilën dhe e bombardon me një seri foljesh ku e pakryera dhe dëshirorja do të përzgjidhen si më të preferuarat, ashtu sikurse ndodh në një përrallë, veçse kjo e jona nuk mund të jetë e tillë. (*Kur u ktheva, me nder me thanë, prej nevojtores, ku për pak nuk më zuri gjumi, e ndoshta dhe do të më zinte, e besa dhe do ta bajsha një sy gjumë të rrastë sikur të çlirohesha mirë dhe sikur duqi i cigares të mos m'i kishte djegë gishtat, u ndala para pasqyrës ku, tue i pa qyrat e jargët që më kishim ardhë deri te themrat e kambëve dhe tue i pre me kujdesin ma të madh me gërshanët që vizllojshin, së paku mue më dukej se i prejsha me gërshanët që vizllojshin aq shumë, sa m'i lëbyrshin sytë, m'u kujtue se kisha harrue ta lëshoj ujin për ta shpërla nevojtores.*)³

² Shiko John Brekman, *Narcissus in the Text*, cit. nga J. Culler, *Sulla decostruzione*, f. 230

³ A. Pashku, *Oh*, Camaj - Pipa, Shkodër 2002, f. 22.

PËRSËRITJA SI ESENCE DHE FORMULË GJUHËSORE NË
HIPERROMANIN “OH” TË ODIN MONDVALSENIT

E, ndërsa regjistri ligjërimitor është nga më të ulët, ku e rëndomta dhe e ndyta jo në trajtën e morales, por në atë të asaj pjese jetësore që ne parapëlqejmë të mos jetë publike, pasi konsiderohet aspak elegante një gjë e tillë, janë prani tashmë e ligjëruar, kohës do t'i duhet shumë pak për të kapërcyer nga një e tashme provizore tek një e shkuar jo shumë e largët, që do të shërbejë si *trampolinë kohësh* ku historitë kryqëzohen e marrin rrugët e tyre.

Në kontrast me të, paralelja e Odinit nis me fjalinë më të shkurtër të mundshme, një trajtë e vetme mohore që, vetëm pasi përmbillet nga një pikë çuditëse, lejon praninë e një frymëmarrje pauze, forma refuzuese më lakonike që ekziston, e cila mbështet njëkohësisht dhe sigurinë e atij mohimi të porsa bërë (Jo!...). Kjo do të jetë natyra e vërtetë e fjalive në jetën gjuhësore të Odin Mondvalsenit, të cilat do të jenë të shkurtra dhe eliptike përgjatë gjithë tekstit, por të plota dhe aspak dembele në përshkrimin e asaj që duan të përçojnë. Njëkohësisht Odinit i duhet shumë më pak për të gjetur vendin e duhur që do t'i shërbejë për të bërë kapërcimet kohore, të cilat do të jenë të shpeshta, veçse e tashmja do të ruhet si koha e preferuar e tij, tek e cila kthehet shumë shpejt. (*Unë isha tek ai vend atje poshtë dhe kisha një emër! Tashti jam këtu dhe kam një emër tjetër...*)⁴

Nëse do të na duhej të përcaktonim se në cilin nga këto dy paralele, individit ka raporte aspak miqësore me gjuhën, do të zgjidhnim rastin e parë, pra përdorimin e gjuhës në regjistrin e saj më të pakëndshëm, apo në të dytin, ku ajo vjen e formësuar përmes fjalive eliptike? Për këtë na duhet të gjejmë përse regjistri ligjërimitor vjen i ulët e pa nivel dhe nëse fjalitë eliptike janë vërtet mungesore apo shpeshësia e tyre ekuilibron gjymtyrët që mungojnë.

Që Odinit i pëlqen të flasë, kjo bëhet shumë shpejt e dukshme përgjatë tekstit. Ai nuk e kursen veten në sqarime të plota madje më tepër nga sa është e nevojshme, me trajta përsëritëse për të njëjtën çështje, të cilave edhe u kthehet vazhdimisht përgjatë tekstit. Po kështu është e qartë që fjalitë *hiper* të gjata të *Atij*, nuk mund të shprehin dëshirë për të komunikuar, por përçojnë thjesht një monotoni që nuk ndryshon asgjë. Asgjë që komunikohet nuk mund të jetë e rëndësishme, për sa kohë që vazhdon të përsiatet në përshkrim të hollësishëm të hundës, djersës apo jargëve, e kjo për më tepër kjo të mos ndryshojë asgjë në rrjedhën e rrëfimit. Këto fjali të mbushura me detaje, tregojnë veç moskomunikim, gjë e qartë kjo në pasazhet që i takojnë *unit* të tij.

Mendoj se pikërisht këtu qëndron strategjia e tekstit; e rëndomta dhe e pështira në rrëfim, fsheh dëshirën e fortë të komunikuesit për të mos komunikuar në fakt. Dëshira për t'u bërë i palexueshëm ndërsa dukesh sikur po komunikon në regjistrin më të thjeshtë të mundshëm, kjo është një shfaqje e qartë e një armiqësie mes *unit* e gjuhës, sepse ndoshta është kjo e fundit që i ka dhënë këtë *fat-jetë*, të cilën nuk e thotë kurrë, por e urren deri në nihilizëm, po aq sa urren dhe gjuhën, të

⁴ K. Trebeshina, Odin Mondvalsen - Një histori dashurie, *Legjenda e asaj që iku*, A. Z. Çajupi, Tiranë 1992, f. 81.

cilën e shfaq për më të shëmtuarën e mundshme, duke i dhënë për të përshkruar objekte të tilla, aspak dinjitoze. Kjo urrejtje pasionale, mund të përftohet vetëm nëse je zhgënjyer nga ç'ke dashur më tepër. Të kesh shpresuar tek gjuha, do të thotë të kesh pranuar horizontin e saj shprehës, duke mos e tradhtuar për asnjë arsye vërtetësinë e saj. Por kur sheh se ajo që ke dashur më shumë, bëhet armë në duart e atyre që duan të të bëjnë keq, atëherë zhgënjimi vjen si i pashmangshëm, e ti ndjen se je tradhtuar nga vetvetja. Nuk mund të zhdukësh gjuhën, por mund të vendosësh të heshtësh! E nëse kjo është e pamundur për një arsye a tjetër, ti mund ta refuzosh atë, duke e bërë shërbëtore të padobishme.

Ndërkohë që raporti që Odini vendos me gjuhën, është tërësisht i ndryshëm. Dëshira e tij për të komunikuar me ato që do e me të gjithë që duan të hyjnë në bashkëbisedim me të, i jep mundësinë jo vetëm atij të shfaqet, por dhe gjithë të tjerëve të bëjnë të njohur vetveten.

Të duash të njohësh, në rastin e Odinit, përputhet me synimin që dhe të tjerët të mund të njohin. Dhe njohja bëhet më e plotë, nëse ti i jep tingull zërit tënd e atij të të tjerëve, sepse e vërteta flet jo vetëm përmes gjuhës së të drejtëve, por dhe gojës së gënjeshtarëve.

Ndoshta për këtë arsye, plotshmëria ligjërimore e Odinit bën që në sytë tanë ai të rezultojë si një original më i plotë dhe varianti i Oh-ut si një përsëritje e kushtëzuar. Por përsëris, kjo mbetet thjesht një ndjesi tipike njerëzore që beson se diku ekziston një variant i parë, i cili domosdo duhet të jetë më i realizuar e pse jo dhe më pozitiv. Të dy individët tanë janë zëra përsëritës, ekzistojnë si subjekte të pavarura, edhe pse jehona të të njëjtit njeri.

b -Përsëritja si kujtesë. “Nëse ndonjëherë dëgjoj një muzikë që më pëlqen, nuk di ta kujtoj më pas; atëherë si mund ta dua një gjë, që nuk arrij ta kujtoj? Kujtoj nga një këngë fjalët. Mund t’i përsëris në pafundësi fjalët që dua.”⁵

Jo pa qëllim e nisa këtë pjesë me citimin e Natalia Ginzburg, e cila dhe nxiti këtë pjesë të punimit, sepse askush më shumë se ajo nuk tregoi, përmes formave të veçanta të përsëritjes në veprat e saj, peshën e fjalës, e cila për t’u kujtuar, sepse jo gjithmonë është e bukur dhe i dashur imazhi që ajo mbart, duhet përsëritur pafundësisht, dhe në këtë mënyrë instrumenti i dukur për të përmbushur këtë, bëhet pikërisht përsëritja.

Ja pse unë nuk harroj kurrë veprimet që Ai bën mbyllur në universin e tij banjo, e cila duhet të kthehet sërish si imazh përsëritës në fund, që unë ta kujtoj këtë individ në botën e tij të mbyllur, të dorëzuar dhe pa as më të voglën dëshirë për të kapërcyer gardhiqet; nuk arrij të mos kujtoj fjalët e plakut dhe mizogamit, xhestet e tyre, veshjet, edhe pse nuk kam një imazh të qartë të pamjes së tyre. Ndaj vazhdoj ta shoh babën duke ngrënë dheun e zi e duke parë më keqardhje dhe nuk ka gjë që e nxjerr nga kujtesa rrotën e diellit e më saktë copat e rrotës së diellit, edhe pse nuk e kujton më numrin e hijeve që i afrohen asaj: “Shikojnë qerren e

⁵ Natalia Ginzburg në “Le piccole virtù”, cituar nga Elena Gagliardi, “Forme della ripetizione nei romanzi epistolari di Natalia Ginzburg”, *Lingua d'autore*, Carocci editore, 2000, f. 86.

PËRSËRITJA SI ESENCE DHE FORMULË GJUHËSORE NË
HIPERROMANIN “OH” TË ODIN MONDVALSENIT

diellit, copat e saj para kambëve të tyre. Afrohet edhe një hije. Edhe ky shikon copat e qerres së diellit. Që të tre marrin nga një copë të qerres së diellit dhe e puthin.”⁶, sepse janë këto copa, të vetmet që të përkujtojnë se dikur nuk kishte ra muga e zogjët nuk ishin të gurëzuar; çuditërisht edhe Putifari mbetet i ngulitur në kujtesë, sepse ai kishte një grua të bukur që e lëviz bishtin poshtë e lart në faqen 95, por që atij nuk i bëhet vonë sepse ka rrogë të mirë dhe i merr ushqimet në bllok, e që në faqen 103, falë rikthimit të tij, mësojmë se është emëruar Sekretar i Dytë i Partisë Komuniste, ndërsa e gjejmë sërish duke kuvenduar me faraonë e sulltanë në faqen 110.

Nuk mund të mos e kujtosh Gentin, edhe pse shfaqet në vetëm pak faqe (43-50), por pikërisht në këtë shtrirje, në tekst gjejmë 55 herë të shfaqur emrin e tij, 21 prej tyre në një fjali të vetme: “Dhe Genti lyp leje të shkojë në lamën e Anicit, e muer lejën për të shkue në lamën e Anicit, shkoj në lamën e Anicit, e muer Anicin, ja qiti krahun Anicit, ecte Genti me Anicin, Genti dhe Anici, Anici dhe Genti hynë në Skodra, hynë dhe u ulën, u ulën Anici dhe Genti, në Skodra u ulën, Genti shtroi për të hangër, shtroi për të hangër e për të pi, për të pi, pi, dhe për të hangër, pinë, shumë pinë, shumë hangrën, shumë pinë, pinë, hangrën, pinë aq shumë sa Gentin dikur e zu gjumi, gjumi, një gjumë i randë, e zu, e zu Gentin, Genti në gjumë (...)”⁷

Në të njëjtën fjali, një pjesë të së cilës cituam, gjendet akoma më i shpeshtë emri i Anicit, i cili përsëritet 31 herë, i pranëvënë me emrin e Gentit, të cilin ndërsa flinte i dehur, i merr të shoqen dhe dy bijtë, gjithmonë duke përsëritur se romakët janë fisnikë, fisnikë. E pas, autori nuk harron të na kujtojë sërish, mbet e thyeme, qerrja, qerrja e diellit.

Memoria krijohet përmes fjalëve dhe janë fjalët ato që Odin Mondvalsen përdor aq bukur, fjalët që përkujtojnë jo vetëm të shkuarën, por edhe të tashmen, sepse dhe e tashmja u duhet kujtuar atyre që e jetojnë me indiferencë e asnjansësi atë: “Bota dikur në kohë të shkuar ka qenë më e madhe jo vetëm se ishim më të pakët, megjithëse fjalët i kishim më të shumta...Po!...Ne kishim më shumë fjalë nga ato që na kishin mësuar nënat tona, kurse tashti fjalët janë më të pakta dhe i fryjnë me qëllim që të mbushin me to hapësirat e pafund që kështu të jenë vetëm fjalët e fryra të atyre që shkrifen e shkrifen dhe përtej asaj që njihet si shkrifje(...) Bota është zvogëluar fare dhe është mbushur me madhërinë e atyre që kërkojnë të varrosin madhërinë dhe nga dëshira për lavdi e atyre që ngërdheshjet e majmunëve i marrin për fillimet e qytetërimit të njerëzimit!”⁸ Fjalët dikur të shumta, pra të lira, e sot të pakta e ç’është më e keqja të fryra, për të mbushur hapësirat e fjalëve të lira të dikurshme, që sot nuk jetojnë më, të mbytura sikurse liria e individit për të qenë vetvetja. Ja sesi mjaftojnë fjalët për të të kujtuar se dhe

⁶ A. Pashku, Oh, f. 56.

⁷ A. Pashku, Oh, f. 76.

⁸ Trebeshina, Odin Mondvalsen, f. 144.

e tashmja duhet kujtuar, në mënyrë që të mund të kuptohet ajo që ka ndodhur e ajo që vazhdon të ndodhë.

Fjala është e rëndësishme sepse ajo i jep jetë ngjarjeve, që pa të do të ishin kujtime të vakta gjer në tretje. Por krijues si Trebeshina e Pashku aq sa besojnë tek fjalët, por aq janë të ndërgjegjshëm në pafuqinë e saj. Ata e dinë se e pozicionuar gabim, jo në vendin e duhur, larg të tjerave fjalë që mund ta fuqizonin, ajo bëhet e dobët dhe e pafuqishme të mbartë peshën e asaj që duhet të përcaktojë. Sikur emri i *Gentit* të mos ishte prezent edhe grafiksht, pra sikur autori të kishte vendosur ta përmendte këtë emër aq sa të ishte e nevojshme për t'i kujtuar lexuesit për kë po flitet, në vend që ta përmendte pa pasur nevojë të priste se kur ishte e rregullt nga ana gramatikore e kuptimore shfaqja e tij, e aq më tepër të mos ta vendoste pranë me të tjerë emra, qofshin ato përcaktues si *Rex Illyrocorum*, apo ai i të vëllait *Platorit* dhe i *Etlevës* të cilën ia vodhi të vëllait, dhe së fundi me emrin e *Scodrës* dhe atë të *Anicit*; atëherë asnjëherë nuk kishte për të qenë i njëjtë pesha e dramatikës së një kombi, që ka të tillë histori mbretërisht që vrasin vëllezërit për gra e poshtërohen e skllavërohen si gra, duke lejuar që qerrja e diellit të mbetet e thyer, ndërsa vetë treten në pluhur. Duhet përkujtuar Gentat, sepse gjithmonë pranë tyre do të gjenden Anicë që do të përdorin dobësinë e tyre për të shkatërruar e asimiluar një komb, qofshin ato të huaj apo vendas, qofshin Anicë apo Mizogamë, gjithmonë në kërkim të së njëjtës gjë, një botë pa *liri ku të ketë vetëm një shtypshkronjë e cila do të botojë vetëm një abetare, vetëm një libër leximi, vetëm një libër të historisë, vetëm një libër të filozofisë, vetëm një tregim, vetëm një novelë, vetëm një gazetë të përditshme, vetëm një revistë, do të ketë vetëm një radiotelevizion, i cili do të emitojë vetëm një këngë, vetëm një (...)*⁹

Fjala është fluturake, por nëse kapet nga rrjeta e përsëritjes, ajo bëhet e qëndrueshme aq sa të ruajë fragmente të reales. Kur një emër rivjen tek ne, ai sjell me vete gjitha kujtimet në lidhje me të, të shkuarën e tij të mirë a të keqe, duke ndërtuar kështu dhe pritshmërinë tonë për të. Kështu ne nuk kemi aspak mëshirë për *Gentin* që dorëzoi *Skodrën*, sepse e dinim që tradhtia ishte në konstruksionin e tij si individ, nuk na vjen keq as për pengmarrjen e fëmijëve, sepse ato gjithsesi nuk kishin një atë, një figurë prindërore që t'u mësonte të bëheshin burrat e ardhshëm. Dhe i gjithë ky përjetim vetëm nga përsëritja e një emri dhe vendosja e tij ku duhet e sa herë që krijuesi do.

Kujtesa konfuze e një plaku që risjell antikitetin si në celuloid, shfaqja dhe zhdukja e hijeve, ujqërve, tiranëve e dështakëve, gjithë ky ripropozim i të shkuarës drejtuar dy të rinjve anës një liqeni artificial, të cilët nxisin rrëfimin, pa dashur të dëgjojnë, sepse mesa duket asnjë prej tyre nuk ka dëshirë të ruajë asgjë nga një kujtesë e shkuar, për sa kohë që e sotmja e tyre ua tregon këto shembje çdo ditë, e mesa duket kanë vendosur të mos kapërcejnë më gardhiqe sepse nuk duan që e liga të bjerë më mbi ta: "*Ma shumë më pëlqen, më pëlqen të pendohem,*

⁹ Oh, 84-85.

PËRSËRITJA SI ESENCE DHE FORMULË GJUHËSORE NË
HIPERROMANIN “OH” TË ODIN MONDVALSENIT

*të pendohem, të pendohem pse nuk më kujtohet, pse nuk më kujtohet të mendohem, të mendohem, të mendohem, të mendohem...*¹⁰

Gjuha është shpesh false dhe e papërshtatshme, por kur krijuesi vendos ta përdorë gjithsesi, ajo bëhet e dobishme dhe me teknika që mund të quhen të pavlera në fushën e të shprehurit letrar, si të padobishme dhe që të vrasin veshin, siç është përsëritja. Të përsëriturit, duke rrezikuar dhe të bëhesh i bezdisshëm, shfaqet në rastin e kësaj vepre, si një gjetje e përsosur për të ngulitur idenë se historia përsëritet e se fytyrat e tiranëve apo tradhtarëve të dikurshëm, mund të jenë fshirë nga koha, por jo shembulli i tyre dhe mundësia që ato të rishfaqen nën të tjerë emra, por gjithmonë me të njëjtën fytyrë, atë të pandryshueshmen që kanë shfaqur në kohën e tyre.

Në të gjitha rastet që morëm si shembull, përsëritja nuk konservon imazhe të këndshme e që duam t'i ruajmë për të tilla, ajo sjell e risjell imazhe të frikshme dhe turpëruese, si një zile alarmi që të kujton se rreziku është afër ose i pranishëm tashmë. Kjo përsëritje e historisë, bën të tmerrshme dhe mundësinë e një tjetër rikthimi në jetë, sepse siç thotë dhe Odin Mondvalsen në mbylljen e veprës: *“Zot i madh! Kush mund të duronte që t'i vdiste dy herë njeriu i dashur?!...Kush mund të duronte ta shihte përsëri atë në pellgun e gjakut të saj?!...A mund ta shikonte përsëri të mbuluar me një çarçaf të bardhë?!...”*¹¹

¹⁰ A. Pashku, Oh, f. 16.

¹¹ K. Trebeshina, Odin Mondvalsen, f. 153-154.